



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.60/01-31158/24
Kaçanik, 17.12.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja X (dhjetë) e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 17 dhjetor 2024 (e Mërkurë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 13:00. Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka-AAK, Betim Shala-LDK, Arben Thaqi-OJQ. Nga Ekzekutivi i komunës nuk mori pjesë ndonjë zyrtar.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e X (dhjetë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2024, data 17 dhjetor, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. OVL UÇK-së në komunën e Kaçanikut ;
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete.

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverbalit ? Procesverbalit i mbledhjes se IX (nëntë) të Komitetit për Komunitete i vitit 2024, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes se IX (nëntë) të Komitetit për Komunitete të vitit 2024, të datës 27.11.2024 / Lënda : 01Nr. 60/01-29344/24.

2. OVL UÇK-së në komunën e Kaçanikut ;

z. Ekrem Livoreka : Kemi pasur një vizitë të planifikuar me OVL, por na është njoftuar se është anuluar.

znj. Lejla Muhaxheri- Çaka: Kam një kërkesë për Organizatën e Veteranëve të Luftës (OVL) në Kaçanik.

A ka ndonjë plan për të siguruar një zyrë më të madhe, pasi hapësira aktuale ku ndodhen është e kufizuar dhe nuk mund të mbuloj nevojat e organizatës.

z. Arben Thaçi : Si është gjendja aktuale e Organizatës së Veteranëve të Luftës (OVL) në komunën e Kaçanikut.

Për shumë veteranë dhe kategoritë e tjera të prekur, gjendja financiare është një shqetësim i madh, sidomos kur përballen me ngrohjen dhe shpenzimet e rritura për energji elektrike gjatë dimrit. Kjo është edhe më shqetësuese për ata që janë lënë anash në mbështetje nga institucionet dhe organizatat përkatëse.

z. Ekrem Livoreka : Lidhur me gjendjen e invalidve në komunën e Kaçanikut, a kanë përkrahje nga shteti për trajtim jashtë vendit, pasi që është një kategori e shenjtë në këtë vend sepse kanë dhënë gjymtyrët e trupit për këtë vend prandaj duhet ta kenë edhe një trajtim të veçantë.

Sa është numri i saktë invalidëve të luftës në komunën e Kaçanikut dhe si funksion Organizata e Veteranëve të Luftës. Çfarë hierarkie dhe aktivitet bëjnë dhe ai trajtojnë mënyrë të barabarta gjithë veteranët e luftës. Ne e dimë se shumica prej tyre janë pa kulm mbi kokë, kemi rastin e fundit për ndarjen e banesave një pjesë shumë e madhe kanë qenë veteranë ose familje të dëshmorëve.


znj. Arta Avdiu : Sa jeni të shqetësuar me thirrjet që vijnë nga Gjykata Speciale. A mendoni se ka anëtarë të Organizatës së Veteranëve të Luftës (OVL) në komunën e Kaçanikut që janë thirrur për të dëshmuar në Gjykatën Speciale.

Sa jeni të kënaqur me rritjen e fundit të pensioneve të veteranëve që ka bërë qeveria. A ka pasur raste të heqjes nga lista e veteranëve në komunën e Kaçanikut. Prej këtyre 19500, sa ka qytetarë të OVL-së komunës tonë.

3. Të ndryshme:

Kryesues i Komitetit Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme ? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 13:30.

Procesmbajtësja
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit për Komunitete
Ekrem Livoreka

